

## **STATUTI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "HAZY NEBULA STUDIOS" SH.P.K**

### **KREU 1**

**Themelimi , Forma, Emri, Kohëzgjatja, Objekti dhe Selia**

#### **THEMELIMI I SHOQËRISË**

##### **NENI 1**

Duke u bazuar në ligjin nr 9901 date 14.04.2008 "Për shoqërите tregtare" dhe ne ligjin nr 131 i dates 26.11.2015 "Per Qendrën Kombëtare të Biznesit ", ne, Erlis Ilir Ciko i datëlindjes 05.04.2004, identifikuar nga nr. personal K40405048F dhe Darti Elvis Lila e datëlindjes 13.08.2004,identifikuar nga nr. personal K40813044C nën vullnetin tonë të lirë sot me datë 08.07.2023 nenshkruajmë miratimin e statutit të shoqërisë "**Hazy Nebula Studios**" sh.p.k .

#### **FORMA E SHOQËRISË**

##### **NENI 2**

Kjo Shoqëri do jetë "Shoqëri Tregtare" e formës "Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar (sh.p.k) "**"HAZY NEBULA STUDIOS" sh.p.k.** Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe atë civil, doganor, tatimor, fiskal dhe akte të tjera ligjore mbi bazën e statutit të saj dhe normat e të drejtës nderkombëtare

#### **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

##### **NENI 3**

Kohëzgjatja e kësaj shoqërie do te jetë pa afat duke filluar nga dita e rregjistrimit në Q.K.B për njohjen dhe regjistrimin e shoqërise si përson juridik.

Erlis Ciko  
Darti Lila

## **EMËRTIMI TREGTAR I SHOQËRISË**

Kjo shoqëri do të quhet "**HAZY NEBULA STUDIOS**" sh.p.k dhe vula e saj ka formën drejtkëndore në të te cilën do shkruhet "**HAZY NEBULA STUDIOS**" sh.p.k.

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

#### **NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë ekonomike te kësaj shoqërie është :**

Ofrim të shërbimeve në fushën e informatikës për individ,biznese, institucione publike, organizata joftimprurese,seli diplomatike,brenda vendit dhe jasht vendit.Trajnime në fushën e informatikës dhe dizajnit. Organizim dhe menaxhim eventesh.

### **SELIA E SHOQËRISË**

#### **NENI 5**

Kjo shoqëri do ketë selinë e vet në adresën, Rruga Nr 4 ,nr pasurise 49/2 , ZK 3072, Plazh, Velipoje, Shkodër, Shqipëri.

## **KREU 2**

**Kapitali Themeltar, Organet e Shoqërise , Administratori ,Eksperti  
Kontabël dhe Prishja e Shoqërisë**

### **KAPITALI THEMELTAR**

#### **NENI 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë me pernjegjesi te kufizuar është në vlerën 100,000 lekë ( një qindmijë lekë). Ortaket themelues te shoqërisë jane, Z. Erlis Ciko i I cili zotëron 1 kuotë me vlerë të përgjithshme 50,000 lekë ( pesëdhjetë mijë lekë) që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, si dhe Z.Darti Lila i cili zotëron 1 kuotë me vlerë të përgjithshme 50,000 lekë ( pesëdhjetë mijë lekë) që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

*Erlis Ciko*  
*Darti Lila*

Shoqëria çel llogari bankare në monedhën vendase (lek) si dhe çdo lloj valute tjeter në banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiarë të aktivitetit të saj.

Ortakët dhe administratori të caktuar nga shoqëria depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në bankat ku është çelur llogaria.

## NENI 7

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitive te kodit civil dhe atij tregtar.

Asambleja e ortakëve ka te drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht ose tërësisht kontributet e saj përfshirë edhe fondet e kontributet në natyrë.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të janë të vërtetuara me akt notarial dhe për një gjë të tillë asambleja e përgjithshme duhet te marrë paraprakisht vendim me shkrim.

## NENI 8

Kapitali themeltar i shoqërisë mund te rritet ose të zvogëlohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme, vendim i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet ne regjistrin përkatës.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme shoqëria ka te drejtë që një pjesë të kuotave të kapitalit themeltar t'ia tjetërsojë një apo disa pësonave fizikë jashtë shoqërisë ose pësonave juridik,vendas apo të huaj mbi bazën e Aktit notarial te tjetërsuar .

Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme për ndryshim të kapitalit themeltar i dërgohet menjëherë QKB-së.

## NENI 9

Kapitali nuk mund te jetë kurrë i përfaqesuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet para kërkesës së drejtarës së QKB për njohjen dhe regjistrimin e shoqërise si person juridik.

Pjesët e kapitalit mund të transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht .

## ORGANET E SHOQËRISË

## NENI 10

Asamblea e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues dhe vendimor i shoqërisë dha ajo ushtron te gjitha kompetencat që ligji "Për shoqëritë tregtare: i njeh asamblesë së ortakëve.

Ergj. Cito  
Ergj. Lila  
Dox. Lila

Asambleja e Përgjithshme mund t'ja delegojë kompetencat një ose shumë administratoreve caktuar prej saj dhe një përsori fizik jashtë ortakerisë së shoqërië vetëm mbi bazën e prokurës.

### **NENI 11**

Me vendim të Asamblesë shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë shtetas shqiptarë apo të huaj ose të bashkohet me një shoqëri tjeter tregtare si brenda dhe jashtë vendit.

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë vendos:

- ❖ Mbi ndryshimet në statutin e shoqërisë
- ❖ Mbi formimin e filialeve degëve dhe përfaqësive jashtë vendit
- ❖ Mbi rritjen apo zvogëlimin e kapitalit themeltar
- ❖ Mbi ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera
- ❖ Mbi transferimin dhe revokimin e likuidatorëve
- ❖ Mbi mënyrën e operimit me mjetet financiare monetare
- ❖ Mbi emërimin dhe shkarkimin e Administratorit

### **NENI 12**

Kjo shoqëri administrohet nga administratori Z.Erlis Ciko identifikuar nga nr.personal K40405048F i cili emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë ndryshimi me konsesusin e ortakëve.

### **EKSPERTI KONTABËL**


#### **NENI 13**

Veprimet ekonomike financiare të shoqërisë mbyllen me datë 31 dhjetor të çdo viti. Për nxjerrjen e rezultatit kontabël mbi bazën e aktivit dhe pasivit ngarkohet nga asambleja e përgjithshme një ekspert kontabël i autorizuar.

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare te shoqërisë akt gjithvletor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë nga ana e asamblesë..

Në perfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit me shkrim; nxjerrjen rezultatit të bilancit vjetor si dhe atë per kontrollet periodike të ushtruara e cila është e detyruar t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë ortakëve për t'l shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

#### **NENI 14**



Nxjerra e rezultateve të bilancit vjetor duhet bërë me saktësi duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen nga ligji për kontabilitetin dhe atyre të sistemit të taksave që janë të detyrueshme per t'u zbatuar nga çdo subjekt privat që ushtron veprimitari tregtare.

### **NENI 15**

Bilanci kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asmablesë së Përgjithshme e cila jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin dhe garantimin e veprimitarisë së rregullt të saj duke patur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

### **NENI 16**

Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas veçimit të fondevë ligjore të mesipërme dhe të atyre për shlyrjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi ortakëvë të shoqërisë sado qofshin ato.

## **PRISHJA E SHOQËRISË**

### **NENI 17**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku edhe para plotësimit të afatit për të cilën është kriuar siç mund të jenë, Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejashëm të veprimitarise së saj një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për falimentimin"

Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimitarisë tregtare.

Në këto raste Asambleja e Përgjithshmë merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likujdimit të shoqërisë duke caktuar një ose disa likuidatore dhe duke shënuar ne çdo document të nxjerrë prej tij dhe emertesën "Shoqëri në likujdim e sipër"

### **NENI 18**


Afati i emëritit të likuidatorit publikohet sipas kushteve që parashtron ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentet që duhen depozituar në aneksin e regjistrat në QKB.

### **NENI 19**

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet vendimeve plotësuese dhe të ligjshme, dhënë nga Asambleja e Përgjithshme si dhe legjislacioni në fuqi.

## **ORTAKET E SHOQËRISË**

Erlis Ciko



Darti Lila

